

LIGJ
Nr. 7560, datë 28.4.1992

PËR SISTEMIN BANKAR NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Banka është institucion i pavarur, që pranon depozita të çdo lloji nga persona fizike e juridikë, ruan sekretin e tyre, jep kredi dhe kryen veprimtari të tjera bankare të njohura me ligj.

Neni 2

Sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë organizohet me dy nivele. Në nivelin e parë bën pjesë Banka e Shqipërisë, statusi i të cilës caktohet me ligj të veçantë. Në nivelin e dytë bëjnë pjesë bankat e tjera.

Neni 3

Banka organizohet në një nga format e mëposhtme:

a) Bankë shtetërore, bankë aksionere me përgjegjës të kufizuar, bankë kooperative dhe bankë private me kapital tërësisht shqiptar.

b) Bankë private ose shtetërore me kapital shqiptar dhe të huaj.

c) Bankë private me kapital tërësisht të huaj.

Banka mund të jetë kombëtare ose rajonale.

Neni 4

Banka e Shqipërisë, nuk e njeh si bankë një ndërmarrje të veçantë, kur konkludon se veprimet e saj të kredisë janë të kufizuara dhe mjetet financiare i siguron nga bankat ose institucionet e tjera financiare.

Neni 5

Bankat kanë të drejtë të hapin zyra ose degë banke jashtë teritorit të vendit, kur kanë licencë nga Banka e Shqipërisë.

Ndërmarrjet, që kanë selinë jashtë Republikës së Shqipërisë dhe që disponojnë licencë për të kryer veprime bankare me një a më shumë degë ose agjenci në Shqipëri, u nën shtrohen dispozitave të këtij ligji, vetëm për veprimtarinë e tyre në Shqipëri.

Neni 6

Ndalohet organizimi i veprimtarisë bankare sipas nenit 3 pa licencë dhe në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Ndalimi i mësipërm nuk ka vlerë për ndërmarrjet që quhen bankë sipas nenit 1.

Neni 7

Ndërmarrjet, ndryshe nga institucionet që kanë licencë për të vepruar si bankë sipas këtij ligji, ndalohet të përdorin emërtimin "Bankë" ose emërtime të njëvlefshme, në qoftë se nuk pranojnë depozita nga persona fizikë e juridikë, nuk japin kredi, ose nuk investojnë në tregun financiar për llogari të të tretëve.

Ky rregull nuk zbatohet për ndërmarrjet, emri i të ciave është njohur me ligj ose me ndonjë marrëveshje ndërkombëtare.

KAPITULLI II DHËNIA E LICENCËS

Neni 8

1. Licenca për të vepruar si bankë merret vetëm pas kërkesës me shkrim në Bankën e Shqipërisë, në formën e përcaktuar nga kjo bankë. Kërkesa shoqërohet me kopjen e aktit të regjistrimit si person juridik, statutin, vendndodhjen e drejtorisë së përgjithshme e të degëve të saj, kur ka të tilla, si dhe shtetësinë e vendbanimin e themeluesve të bankës. Kërkesa shoqërohet me një program veprimtarie për 3 vjetët e parë të aktivitetit të saj. Licenca jepet nga Banka e Shqipërisë, kur:

- a) bindet për vërtetësinë e kapitalit dhe të burimeve të tjera financiare;
- b) këshilli i bankës përbehet nga jo më pak se 2 persona me cilësitë dhe përvojën që kërkohet për drejtimin e bankës;
- c) veprimtaria bankare plotëson nevojat e rajoneve të propozuara;
- ç) propozimi ka efekte pozitive mbi konkurrencën në tregjet ku do të shërbehet;
- d) banka ka kushte për t'u bërë fitimprurëse për një periudhë të arsyeshme kohe;
- dh) banka jep garanci që të respektojë ligjin dhe rregullat e Bankës së Shqipërisë.

Neni 9

1. Banka e Shqipërisë detyrohet të japë miratimin ose refuzimin e kërkesës për licencë brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së plotë të saj.

Vendimi jepet me shkrim dhe është i formës së prerë.

Në rast se kërkesa refuzohet, në vendim jepen arsyet ligjore të refuzimit.

Kërkesa mund të përsëritet kur plotësohen arsyet e refuzimit.

2. Licenca e dhënë për të vepruar si bankë është e patjetërsueshme dhe e pacaktuar në kohë.

Në raste të veçanta Banka e Shqipërisë kufizon ose përjashton në licencë kryerjen e veprimeve që sipas gjykimit të saj kërkojnë kualifikim të veçantë.

Neni 10

1. Licenca e dhënë mund të revokohet nga Banka e Shqipërisë në rast se:

- a) është dhënë në bazë të deklaratave false të parashtruara në kërkesë;
- b) nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në licencë ose vihen re shkelje që përcaktohen në nenin 44 të këtij ligji;
- c) bankës me vendndodhje jashtë shtetit, që ka agjenci ose degë në Shqipëri, i revokohet licenca nga vendi përkatës;
- ç) pronari ose pronarët e bankës vendosin të shpërndajnë ose likuidojnë bankën;
- d) banka pushon së ekzistuari ligjërisht si subjekt i pavarur, si pasojë e shpërndarjes, falimentimit, shkrirjes, bashkimit, ndarjes dhe thithjes së saj.

2. Vendimi i revokimit të licencës i jepet me shkrim bankës së interesuar dhe është i formës së prerë.

Neni 11

Çdo bankë mund t'i kërkojë me shkrim Bankës së Shqipërisë që të revokojë licencën e saj për

të vepruar si bankë.

Brenda 90 ditëve pas marrjes së kërkesës, Banka e Shqipërisë duhet të vendosë për kërkesën. Vendimi i komunikohet me shkrim bankës dhe, në rast refuzimi, shpegohe shkaqet.

Neni 12

Licencat dhe aktet e revokimit të tyre botohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Pas publikimit të revokimit të licencës ndalohe tërheqja e burimeve financiare nga persona juridikë e fizikë dhe dhënia e kredive. Brenda një periudhe që caktohet nga Banka e Shqipërisë, banka likuidon pasuritë e saj, marrëdhëniet për depozitat dhe detyrimet.

Neni 13

Banka e Shqipërisë mban regjistër, ku evidencohen emërtimi, adresa dhe selia e ndërmarrjes së lejuar për të vepruar si bankë.

Banka me licencë të revokuar çregjistrohet.

Kopja e regjistrimit është e hapur për verifikim publik.

Neni 14

Zyrat përfaqësuese të institucioneve financiare të huaja ose degët e tyre në Shqipëri, nuk lejohet të pranojnë depozita për persona fizikë a juridikë shqiptarë. Edhe institucionet e tjera financiare të huaja, që nuk kanë licenca për të vepruar në Shqipëri nuk lejohet të marrin depozita në para, drejtëpërdrejt ose nëpërmjet agjentëve.

KAPITULLI III ADMINISTRIMI DHE PRONËSIA

Neni 15

Banka administrohet nga Këshilli Drejtues i Bankës, i cili është organ vendimor. Ajo ka Komitetin e Kontrollit dhe mbikëqyrjet nga Këshilli Mbikëqyrës.

Banka mund të mos ketë këshill mbikëqyrjeje, në rast se nuk kërkohet një gjë e tillë nga ndonjë ligj tjetër. Në kuptim të këtij ligji anëtarët e organeve të mësipërm dhe drejtorët e drejtorive quhen administratorë.

Neni 16

1. Në licencat e dhëna nuk lejohen ndryshime pa marrë më parë leje me shkrim nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka funksionon sipas statutit të saj, që hartohet në përputhje me licencën e dhënë.

3. Statuti i bankës dhe çdo ndryshim miratohet nga Këshilli Drejtues i Bankës. Kopja e statutit depozitohet në Bankën e Shqipërisë.

4. Çdo bankë depoziton në bankën e Shqipërisë dhe në gjykatë, sipas juridiksionit ku ka degë, kopje të njësuar të licencës e statutit, listë të drejtuesve të bankës, përshkrim të kompetencave të tyre, së bashku me specimentet e nënshkrimit.

Neni 17

Kompetencat e Këshillit Drejtues të Bankës, të Komitetit të Kontrollit dhe të Këshillit Mbikëqyrës përcaktohen në ligj dhe me statut.

Neni 18

Këshilli Drejtues i Bankës dhe Këshilli Mbikëqyrës përbëhen nga jo më pak se dy anëtarë.

Neni 19

1. Komiteti i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që caktohen nga aksionarët ose pronarët e bankës dhe ka këto detyra:

a) përcakton e mbikëqyr procedurat llogaritëse të bankës dhe kontrollon llogaritë dhe regjistrimet e saj;

b) kontrollon zbatimin e rregullave dhe i raporton Këshillit Drejtues të Bankës;

c) jep mendime për të gjitha problemet, që i kërkojnë nga Këshilli Drejtues i Bankës.

2. Komiteti i kontrollit mbledhet një herë në tre muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme, kur thirret nga Këshilli Drejtues i Bankës. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Abstenime nuk lejohen.

3. Me kërkesën e tij komiteti i kontrollit ndihmohet nga ekspertë që caktohen nga Këshilli Drejtues i Bankës.

Neni 20

Të gjithë personat e zgjedhur ose të caktuar si administраторë të një banke duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura nga Banka e Shqipërisë për kualifikimin, përvojën dhe reputacionin e mirë.

Neni 21

Hapja e një dege, zyre apo agjensie bankare është objekt i politikës së Bankës së Shqipërisë.

Neni 22

Shkrirja, bashkimi, ndarja ose thithja e një banke bëhet me autorizim paraprak të Bankës së Shqipërisë.

Pranimi i shkrirjes, bashkimit, ndarjes ose thithjes bëhet në rastet kur jepet licencë për të vepruar si bankë.

Neni 23

Shuma minimale e kapitalit të paprekshëm, fondi minimal i rezervës dhe pjesa në përqindje e fitimit, që do të përdoret për shtimin e tyre, përcaktohet nga Banka e Shqipërisë, sipas kategorive të bankave.

Struktura e kapitalit të paprekshëm, fondit të rezervës dhe fitimit përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

Neni 24

Transferimi i mbi 15% të kapitaleve, nga një person ose një grup personash, që veprojnë së bashku dhe që zotërojnë më shumë se 15% të kapitalit të bankës, nëpërmjet një ose më shumë transaksioneve bankare, bëhet me autorizim me shkrim nga Banka e Shqipërisë.

KAPITULLI IV RREGULLA PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE

Neni 25

Banka kryen veprimtarinë e saj sipas parimit të shmangies së rrezikut, në pajtim me llojshmërinë, format e pagesave dhe rregullat e udhëzimet e Bankës së Shqipërisë.

Neni 26

1. Banka për çdo veprim krediti, mban dokumente ligjore:

a) Aktkreditin, dokumentet që tregojnë përdorimin e saj, statusin ligjor dhe vlerën e pranuar e të nënshkruar të garancive të kërkuara e të paraqitura.

b) regjistrimin financiar të klientit e të çdo garantuesi, që shërben si bazë për miratimin e veprimeve të transaksioneve të kredisë.

c) vendimi i departamentit e drejtorit përkatës, që miraton veprimet e kredisë të nënshkruara nga personat përgjegjës. Në raste të veçanta kur vendimi merret nga Këshilli Drejtues i Bankës, nxirret një kopje e ekstraktit të protokollit të mbledhjes, ku është miratuar veprimi i kredisë.

2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë dokumente e procedura plotësuese tej kushteve të parashikuara në pikën "1" të këtij neni. Vetëm Banka e Shqipërisë lejon thjeshtimin e dokumentacionit për kreditin në rast të shumave të vogla, për skontime apo për dokumente tregtare. Këto miratohen nga drejtuesit e degëve, agjencive e zyrave të tjera të Bankës së Shqipërisë brenda kufijve të kompetencave të tyre.

Neni 27

Banka detyrohet të respektojë kufijtë e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë si më poshtë:

a) raportet maksimale që duhet të ruhen ndërmjet mjeteve të saj, mjeteve të dhëna me risk e zërave jashtë bilancit dhe kapitalit të saj të paprekshëm, rezervës dhe fitimit;

b) shumën maksimale të kredisë të shprehur në përqindje ndaj kapitalit të saj të paprekshëm, rezervës dhe fitimit, që banka lejohet t'i japë çdo huamarrësi të vetëm ose grupi huamarrësish të ndërlidhur.

c) nivelin e shumës maksimale të kredisë, të shprehur në përqindje ndaj shumës së kredisë së dhënë dhe të pakthyer, që banka lejohet t'u japë dhjetë huamarrësve më të mëdhenj të saj, duke përfshirë edhe grupet e huamarrësve të ndërlidhur.

Neni 28

Bankat detyrohen të zbatojnë kërkesat e caktuara nga Banka e Shqipërisë për:

a) madhësinë minimale të rezervave likuide ose të kategorive të veçanta të këtyre rezervave, në varësi nga masa ose ndryshimi i masës së mjeteve, garancive ose të kategorive specifike të tyre, apo në varësi nga masa ose ndryshimi i madhësisë së detyrimeve apo të kategorive specifike të tyre, me kusht që banka të plotësojë kërkesën e rezervave likuide, duke mbajtur depozita me një vlerë të barasvlefshme pranë Bankës së Shqipërisë për:

b) shumën maksimale të kredive, të investimeve financiare dhe të garancive ose të kategorive të tjera specifike;

c) kërkesa të imponuara nga rrethana të veçanta lidhur me përqindjet e interesit dhe të detyrimeve të tjera që paguhen nga banka, si dhe kërkesa për maturimin e kushte të tjera, të zbatueshme për depozitat, garancitë dhe detyrime të tjera, të shprehura në lekë a në monedhë të huaj;

ç) kërkesa të imponuara nga rrethana të veçanta lidhur me përqindjet e interesit, maturimit dhe kushteve të tjera të zbatueshme të ndonjë tipi a forme për pakësimin ose shtimin e financimeve, ose të tërësisë së detyrimeve që përfshihen në të;

d) shumat që duhet të rezervohen kundrejt huave të dyshimta dhe pa shpresë arkëtimi. Llogaritja e fitimit bëhet duke filluar nga dita kur këto hua arkëtohen në monedhë.

dh) bankat duhet të respektojnë ndalimet, kufizimet dhe kushtet për:

- llojet ose format e kredive e të investimeve financiare ose tërësinë e detyrimeve që lidhen me to;

- kontrollin e maturimit të mjeteve e të detyrimeve dhe të zërave jashtë bilancit;

- pozicionet e pambuluara të monedhës së huaj.

Neni 29

Çdo bankë detyrohet t'u bëjë të njohur rregullisht klientëve të saj të dhënat për kushtet e përqindjet e interesit vjetor, që lidhen me depozitat, dhënien e kredisë dhe ndryshimet e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e llogaritjes.

Neni 30

Bankat pa autorizimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë nuk kryejnë veprimtaritë e mëposhtme për:

- a) emetimin ose shitjen e letrave me vlerë brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) pakësimin e kapitalit të saj nëpërmjet riblerjes së aksioneve ose shpërndarjes së mjeteve rezervë;
- c) blerjen e aksioneve ose bërjen pjesëtar ne to të një shume më të lartë se 10% të kapitalit të ndërmarrjeve ose të vënies në pronësi të përbashkët, apo të bashkimit me ndërmarrje të tjera, përveç bankave a institucioneve të këtij lloji që përcaktohen nga Banka e Shqipërisë;
- d) për dhënien e lejes për investimet e përshkruara në shkronjën "c", deri në 25% të kapitalit të paprekshëm, të rezervave dhe të fitimit të saj.

Neni 31

1. Kufizimet sipas nenit 30 të këtij ligji nuk zbatohen për këto raste:

- a) blerjen e aksioneve ose e vlerave të tjera kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna. Në këtë rast banka blerëse disponon të gjitha aksionet ose vlerat e marra për një vit, derisa të jepet zgjatje e huasë nga Banka e Shqipërisë ;
- b) blerja e aksioneve ose e vlerave të tjera si një agjent;
- c) blerja e aksioneve me qëllim rishitjeje të tyre të tretëve.

2. Banka ndalohet të bëjë kontrata, marrëveshje a të miratojë praktika të çfardo lloji, nëpërmjet të cilave siguron pozitë dominuese mbi paratë, tregjet valutore e financiare. Nuk lejohet pjesëmarrja në praktika manipuluese për të ruajtur avantazhe të padrejta për vete ose për të tretët.

KAPITULLI V MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONA TË LIDHUR ME TË

Neni 32

1. Banka kryen veprime me persona të lidhur me bankën në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Në kuptimin e këtij ligji, termi "person i lidhur me të" është:

- a) secili nga administratorët të përcaktuar në nenin 15 të këtij ligji;
- b) çdo shoqëri ose ndonjë nga administratorët dhe aksionistët kryesorë të kësaj shoqërie, që kontrollon bankën;
- c) bashkëshortja ose ndonjë nga të afërmit, deri në brezin e tretë të ndonjërit nga administratorët e bankës, ose ndonjë nga administratorët kryesorë të ndonjë shoqërie që kontrollon bankën;
- ç) cdo shoqëri, në të cilën ndonjë nga personat e mësipërm zotëron direkt ose indirekt më shumë se 10% të kapitalit të themelimit;
- d) ndonjë nga aksionistët kryesorë të bankës dhe të ndonjë shoqërie nën kontrollin direkt dhe indirekt të tyre;
- dh) person juridik a fizik që zotëron një bankë dhe administratorët e tij, si dhe çdo ent ligjor që zotërohet direkt ose indirekt prej tyre, dhe administratorëve të tyre;
- e) personat e lidhur me çdo institucion financiar që përbën një grup institucioneve financiare të ndërlidhura, konsiderohen si persona të lidhur me secilin nga institucionet e këtij grupi.

Neni 33

Në kuptim të nenit 32 :

- a) "Aksionist kryesor" kuptohet pronari që zotëron më shumë se 10% të kapitalit të themelimit të një ndërmarrjeje.

- b) "Kontroll" në lidhje me një shoqëri ose institucion financiar kuptohet:
- të zotërosh më shumë se 50% të aksioneve;
 - të kesh pushtet për të zgjedhur pjesën më të madhe të drejtuesve të shoqërisë;
 - të kesh ndikim në përcaktimin e politikës së drejtimit të shoqërisë ose institucionit.

Neni 34

Banka nuk jep kushte favorizuese për person të lidhur me të.

Në kuptim të këtij neni "kushte favorizuese" quhen:

- a) veprime, që nga natyra, qëllimi dhe rreziku që kanë, nuk kryhen për klientët e tjerë, por kryhen për persona të lidhur;
- b) interesi, komisionet bankare, detyrime të tjera dhe pranimi i garancive janë më të ulëta se sa ato të klientëve të tjerë.

Neni 35

Banka u jep kredi personave të lidhur me të në kuptim të nenit 32 të këtij ligji, me autorizim të Këshillit Drejtues të Bankës, të bazuar në një raport të drejtorisë përkatëse. Raporti përshkruan marrëdhënie të personit të lidhur me të për veprimin që do të bëhet, gjendja financiare e kërkuarit dhe vlerësimi i krëdibilitetit të tij.

Anëtari i Këshillit Drejtues të Bankës, largohet nga mbledhja gjatë kohës, kur këshilli diskuton dhe vendos për veprime të një personi tjetër, me të cilin anëtari i këshillit ka lidhje martesore, gjaku, farefisnie ose interesa fitimi.

Kredia e dhënë nga banka punonjësit të saj nuk duhet ta kalojë 24 hërë pagën e tij mujore. Shuma e kreditit të dhënë nga banka punonjësve të saj nuk do të kalojë 10% të kapitalit të themelimit të bankës.

KAPITULLI VI

LLOGARITË, KONTROLI, INSPEKTIMI DHE MËNYRA E RAPORTIMIT

Neni 36

Banka mban llogaritë e nevojshme dhe përgatit raportet financiare, për të pasqyruar saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat llogaritëse gjendjen e saj financiare.

Kur banka merr pjesë me më shumë se 50% të kapitalit të themelimit të saj në një ose më shumë banka të tjera, ajo mban llogaritë e nevojshme dhe përgatit raportet financiare, për të pasqyruar saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat llogaritëse të njesuara, gjendjen financiare edhe të këtyre bankave.

Neni 37

Banka cakton një kontrollor të pavarur prej saj, i cili miratohet nga Banka e Shqipërisë. Kontrollori ka këto detyra:

- a) ndihmon në mbajtjen e llogarive, regjistrimin e operacioneve dhe të veprimeve të bankës, në përputhje me rregullat kontabël;
- b) në përputhje me rregullat përkatëse përgatit raportin vjetor për gjendjen financiare (bilancin, llogarinë fitime e humbje dhe dokumente të tjera të këtij lloji) të bankës dhe jep mendime për vërtetësinë e gjendjes financiare të bankës;
- c) informon Këshillin Drejtues të Bankës, Këshillin Mbikëqyrës dhe Bankën e Shqipërisë, për çdo parregullsi a të metë të vëzhguar gjatë operacioneve, veprimeve, procedurave, regjistrimeve ose llogarive të bankës që mund t'i sjellin asaj humbje materiale.

Neni 38

Bilanci i bankës, raporti vjetor dhe raporti i kontrollorit për vitin financiar botohet në buletin

zyrtar të bankës.

Neni 39

Banka është objekt i kontrollit nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë dhe nga kontrollori i caktuar prej saj. Në kontrollin ndaj bankave, Banka e Shqipërisë dhe drejtoritë e kontrollit mund të:

a) shqyrtojnë llogaritë dhe dokumentacionin e duhur, librat dhe çdo dokument tjetër në arkivat e bankës;

b) kërkojnë nga administratorët, punonjësit dhe agjentët e bankës që të japin informacione për çështje, e cila lidhet me drejtimin dhe operacionet, siç do të kërkojnë ata.

Neni 40

Dispozitat e neneve 38 deri 39 të këtij ligji zbatohen edhe për bankat që janë degë të institucioneve të huaja financiare ose degë të enteve ligjore të veçanta.

Bilancet dhe raportet financiare të këtyre degëve mund të përgatiten në mënyrë të veçantë sipas statutit ose rregullores së bankës.

Një organ përfaqësues i institucionit të huaj financiar mund të funksionojë si një komitet kontrolli për këto degë, për zbatimin e këtij ligji.

Neni 41

Banka përgatit raporte periodike sipas rregullave të caktuara nga Banka e Shqipërisë, duke dhënë informacion të nevojshëm për administrimin dhe operacionet e saj, likuiditetet dhe fitimin.

KAPTULLI VII SHKELJET DHE DËNIMET

Neni 42

Administratorët e Bankës së Shqipërisë, për shkeljet e rregullave të përcaktuara në nenet 10 shkronja "a", 26, 27, 28, 29, 30, 31 paragrafi i dytë e i tretë, neni 34, 35 paragrafi i fundit, 36 dhe 41 të këtij ligji, kur ato nuk formojnë vepër penale dënojnë për kundravajtje administrative bankat ose administratorët e tyre me gjobë gjër në 5000 lekë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga shpallja ose njoftimi i tij, të Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, akti i të cilit është i formës së prerë.

Neni 43

Banka e Shqipërisë kur shkelen dispozitat e këtij ligji nga bankat ose administratoret e tyre, vendos rre gullimin e gjendjes, duke marrë këto masa:

a) jep paralajmerime me shkrim për kufizimin e veprimeve të ndryshme bankare deri në heqjen e licencës;

b) cakton detyra për bankën që të marrë masa përmirësuese duke përfshirë edhe ato që kufizojnë operacione të bankës;

c) lëshon urdhër me shkrim për ndalimin dhe shmangien e shkeljeve;

ç) organizon mbledhjen e këshillit të aksionistëve ose pronarëve të tjerë të bankës, për të diskutuar masat e nevojshme që duhen marrë;

d) vendos për drejtimin e bankës me kujdestari, me anë të personave të autorizuar prej saj, të cilët veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

dh) revokon licencën e bankës.

Neni 44

Dënimet administrative dhe masat që jepen sipas neneve 42 e 43 të këtij ligji, nuk pengojnë

marrjen e masave civile a penale që përcaktohen në dispozitat ligjore.

Dënimet jepen në përputhje me rëndësinë e shkeljes dhetë dëmit të shkaktuar. Këto dënime zbatohen edhe për individet ose entet ligjore që kryejnë veprime bankare pa licencë.

Neni 45

Gjobat e vendosura arkëtohen për llogari të buxhetit të shtetit.

KAPITULLI VIII KUJDESTARIA DHE LIKUIDIMI

Neni 46

Në rast se gjendja financiare e bankës nuk përballon kërkesat minimale të veprimtarisë së saj sipas këtij ligji me vendim të Bankës së Shqipërisë, banka vihet nën kujdestari për të mbrojtur, rregulluar dhe zgjidhur gjendjen e saj financiare.

Neni 47

Vendimi për vendosjen e kujdestarisë duhet të përmbajë:

- a) arsyet për vendosjen e kujdestarisë;
- b) emrin e personit të caktuar, që mund të jetë ose jo punonjës i Bankës së Shqipërisë;
- c) vënien nën kujdestari për një afat jo më shumë se 6 muaj;
- ç) bllokimin ose jo të depozitave a të fondeve të tjera të klienteve;
- d) sekuestrimin e pasurisë personale të administratorëve të bankës, kur ata ngarkohen me përgjegjësi personale për humbjet që kanë shkaktuar, me qëllim që të garantohet pagesa e humbjeve të mundshme të të tretëve.

Vendimi i marrë si më sipër hyn në fuqi në datën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 48

Aktet e nxjerra nga banka e vënë nën kujdestari janë të pavlefshme në qoftë se kujdestaria vendos ndryshe.

Neni 49

Gjatë kohës që zgjat kujdestaria sipas shkronjës "c" të nenit 47, pezullohet veprimtaria e administratorëve të bankës. Ata kthehen në detyrat e tyre, kur nuk janë të cilësuar si të paaftë nga Banka e Shqipërisë.

Neni 50

Kujdestaria kërkon zëvendësimin e shpejtë të zyrtarëve të bankës sipas listave të depozituara në Bankën e Shqipërisë dhe në gjykatën e rrethit të juridiksionit ku është Drejtoria e Përgjithshme e Bankës.

Neni 51

Personi kujdestar i caktuar nga Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë çdo masë për të normalizuar situatën e bankës, duke përfshirë edhe mbylljen e degëve, agjencive e të zyrave të tjera, si dhe shkarkimin e administratorëve e të punonjësve që gjykohen të tepërt, ose të papërshtatshëm për të kryer detyrat e tyre.

Neni 52

Gjatë periudhës së kujdestarisë Banka e Shqipërisë mund t'i japë ndihmë financiare bankës në kushtet e caktuara nga ajo, për të mbuluar çdo deficit të përkohshëm për pagesat.

Neni 53

Kur Banka e Shqipërisë çmon se vazhdimi i veprimtarisë së bankës të vënë nën kujdestari, është më i kushtueshëm se shpërndarja e saj, deklaron falimentimin dhe e likuidon atë.

Neni 54

Kërkesat e Bankës së Shqipërisë për fondet e dhëna bankës gjatë vënies nën kujdestari, kanë përparësi ndaj të gjithë kërkesave të tjera mbi këtë bankë.

Neni 55

Kujdestaria hiqet:

- a) pas përfundimit të afatit të caktuar në vendimin për vendosjen e kujdestarisë ose në fund të zgjatjes së këtij afati të vendosur nga Banka e Shqipërisë e të shpallur në Fletoren Zyrtare;
- b) kur Banka e Shqipërisë gjykon se banka mund të veprojë normalisht;
- c) pas likuidimit të bankës në përputhje me ligjin.

KAPITULLI IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 56

Punonjësit e bankës dhe personat e tjerë që ngarkohen për kontrollin e veprimtarisë bankare, detyrohen të ruajnë sekretin e çfarëdo informacioni që ata marrin gjatë shërbimit të tyre në bankë. Informacioni mund t'u jepet administratorëve të bankës ose, sipas kërkesës me shkrim, gjykatës, hetuesisë e prokurorisë, sipas procedurave të parashikuara nga ligji ose në statutin e bankës.

Neni 57

Banka ka emblemën dhe vulën e saj me shënjat përkatese.

Neni 58

Bankat e nivelit të dytë detyrohen të paguajnë tatimet dhe taksat e parashikuara me ligj.

Neni 59

Institucionet që veprojnë si bankë në kohën kur ky ligj hyn në fuqi, duhet të kërkojnë licencë për të vazhduar veprimtarinë si bankë.

Neni 60

Rregulloret, udhëzimet dhe urdhërat e lëshuara nga Banka e Shqipërisë e që i përkasin më shumë se një institucioni, shpallen në Fletoren Zyrtare dhe hyjnë në fuqi nga data e shpalljes, ose në datën e përcaktuar në rregullore, në udhëzim a në urdhërin përkatës.

Neni 61

Dekreti nr.7493, datë 1.12.1990 "Për Bankën Shqiptare të Tregtisë" dhe ligji nr.7505, datë 31.7.1991 "Për Bankën e Kursimeve", shfuqizohen.

Neni 62

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.173, datë 4.5.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha